



Emri

Hyrja Në Forum

Help

Regjistrimi

 Të ruaj të dhënat?

Home

Forumi

Postime te Reja

Postimet e Sotme

Pyetësori

Kalendari

Community

Forum Actions

Lidhjet e Shpejta

Kërkim i Avanco

[Forum](#)
[Të Ndryshme](#)
[Sociale](#)
[Arsim](#)
 Programi TEMPUS mbështet 10 institucione të arsimit të lartë

If this is your first visit, be sure to check out the **FAQ** by clicking the link above. You may have to **register** before you can post: click the register link above to proceed. To start viewing messages, select the forum that you want to visit from the selection below.

+ Përgjigju Temës

Duke shfaqur rezultatin 1 deri 1 pre

Veglat E Temës

Display

03-26-2010 07:50 PM

#:

**Ismet Azizi** **Programi TEMPUS mbështet 10 institucione të arsimit të lartë**

Vendas

Vendas



Antarësuar Jan 2009

Vëndndodhja Gjilan

Postime 4,358



Prishtinë, 26 mars -  
Ministria e Arsimit,  
Shkencës dhe  
Teknologjisë dhe WUS  
Austria në

Përmirësi duke Cituar

bashkëpunim me partnerët e tjerë vendorë dhe evropianë, ka mbajtur sot takimin nismëtar dhe të partnerëve për projektin: "Mbështetja dhe Zhvillimi i Strukturave për Sigurimin e Cilësisë në Institucionet Private të Arsimit të Lartë", të mbështetur përmes programit TEMPUS, e të financuar nga Komisioni Evropian.

Qëllimi kryesor i projektit është të kontribuojë në themelimin, forcimin dhe sigurimit të cilësisë në 10 institucione private të arsimit të lartë të Kosovës.

Ndërsa, qëllimi afatgjatë është: përmirësimi i cilësisë së këtyre institucioneve në bazë të Strategjisë mbi Arsimin e Lartë për periudhën 2005-2015, parimeve të Procesit të Bolonjës si dhe dokumenteve të tjera relevante.

Ministri i Arsimit, Enver Hoxhaj, tha se Republika e Kosovës gjatë viti 2008/09 ka bërë përpjekje maksimale që ta definojë shtetin tonë të ri si shtet, në të cilin dija dhe kërkimi shkencor janë shtylla për zhvillim ekonomik, për modernizim social dhe për zhvillim kulturor.

"Jam shumë i nderuar që një prioritet që e kemi filluar në vitin 2008/09 dhe i cili ka qenë i përmbledhur me tri fjalë, cilësi, cilësi, dhe vetëm cilësi, kemi bërë që në kuadër të procesit të akreditimit, të vlerësimit të jashtëm, ta rregullojmë tregun e dijes në fushën e arsimit të lartë dhe sot të dallojmë shumë prej vendeve tjera të rajonit sa i takon asaj që institucionet tona publike dhe private të mund të maten dhe të

krahasohen me ato, të cilat ekzistojnë në Bashkimin Evropian”, tha ai.

Ministri Hoxhaj theksoi se për MASHT-in, sektori publik dhe sektori privat në Kosovë janë të barabartë për nga roli, funksioni dhe qëllimet. “Por, përderisa sektori publik ekziston për shkak të domosdoshmërisë publike, sektori privat duhet të ekzistojë për shkak të cilësisë dhe të fleksibilitetit që ka ekonomia jonë e tregut”.

“Një projekt, të cilin sot ne e promovojmë për herë të parë, e ka peshën e tij meqë juve të gjithëve që jeni të pranishëm ju mundëson që të zhvilloni struktura, të zhvilloni mekanizma që cilësia mos të jetë diçka që e kërkon vetëm ligji për arsimin e lartë, vetëm Ministria e Arsimit, vetëm qytetarët e Kosovës, por të jetë diçka çka ju ja vendosni si qëllim vetes për një ofrim të programeve studimore, të cilat realisht mund të maten dhe të krahasohen me ato që i kem në BE”, theksoi ministri Hoxhaj.

But Dedaj, përfaqësues i Wus Austrias theksoi se duke iu përgjigjur përkushtimit që ka pasur MASHT-i në këtë drejtim, “ju kemi veshur punës që së bashku me Universitetin e Strasburgut ta zhvillojmë këtë projekt, i cili do t’i kontribuojë zhvillimit të cilësisë në IPAL të Kosovës”.

Përfaqësuesja e Komisionit European në Kosovë, Sophie Beamont tha se ky projekt, do t’i ndihmojë

drejtpërdrejtë studentëve, por edhe ekonomisë së Kosovës. "E rëndësishmja e këtij projekti është që ofertat që ofrohen nga programet e TEMPUS-it, të kenë rezultate në plotësimin e kërkesave të studentëve, e që ndër të tjera është sigurimi i cilësisë", tha ajo.

Ndërsa, përfaqësuesi i Universitetit të Salzburgut, Peter Eckl theksoi se programet e TEMPUS-it, duhet të gjejnë realizim edhe në Kosovë, mirëpo edhe nëse kjo do të jetë në një tempo të ngadalshëm, institucionet e larta profesionale arsimore, fillimisht duhet t'i informojnë ata rreth këtyre programeve në mënyrë që qasja e studentëve drejt këtyre programeve të jetë më e lehtë.

Përfaqësuesit e Institucioneve Private të Arsimit të Lartë e vlerësuan mundësinë që po iu jepet me këtë projekt, në mënyrë që ato të ngritin edhe më tej cilësinë dhe të jenë në shërbim sa më të mirë të studentëve.

Përfitues të projektit janë 10 Institucione Private të Arsimit të Lartë të Republikës së Kosovës. Projekti implementohet me ekspertizën e ofruar nga tri universitete të njohura evropiane në lëmin e sigurimit të cilësisë: Universiteti i Salzburgut, University College Cork, Irland dhe Universiteti POLITEHNICA në Bukuresht, WUS Austria's, dhe në mbështetje strategjike të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe Agjencionit

Kosovar për  
Akreditim.

+ Përgjigju Temës

Quick Navigation [Arsim](#) [Kreu](#)

« Tema Mëparshme | Tema në Vazhdim »

**Bookmarks**

-  [Digg](#)
-  [del.icio.us](#)
-  [StumbleUpon](#)
-  [Google](#)
- y
-  [FaceBook.com](#)

**Regullat e Postimit**

You **may not** post new threads

You **may not** post replies

You **may not** post attachments

You **may not** edit your posts

**BB code is ON**

**Fytyrat janë Hapur**

Kodi **[IMG]** është **Hapur**

Kodi HTML është **Mbyllur**

[Forum Rules](#)

-- Albanian 

Na Kontaktoni [Kokaj](#) [Arkiva](#) [Kre](#)

Te gjitha kohët janë në GMT +1. Ora tani është 01:03 PM.

Mundësuar nga: vBulletin Versioni 4.0.1 (Albanian-Shqip)  
©2000 - 2010, Jelsoft Enterprises Ltd. [www.kosovanetworks.com](http://www.kosovanetworks.com)

Hap email@kokaj.net

[Hap Email](#)

[Hyr në Email](#)